

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR "INTERBALKAN MEDICAL
ASSISTANCE" SH.P.K.**

Sot më datë 02 Mars 2021 (dymijë e njëzet e një), Z. Margarit Dado shtetas Shqiptare, i lindur në Shqipëri, më 04.10.1983, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I31004089C. i cili ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA,
KOHËZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "Interbalkan Medical Assistance" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "Interbalkan Medical Assistance" Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 3.2. Në mënyrë më specifike, Shoqëria do të kryejë aktivitet tregtar:
Ndermjetesim nderkombetar per:
 - Kompani Sigurimi nderkombetare te huaja,
 - Servise Automjetesh. Sherbim Karotrec. Servis Automjeti ne rruge, Asistence Rrugore,
 - Transport i klienteve ne raste aksidenti

**ARTICLES OF ASSOCIATION OF THE LIMITED
LIABILITY COMPANY "INTERBALKAN MEDICAL
ASSISTANCE" L.T.D.**

Today, on March 02, 2021 (two thousand twenty-one) Mr. Margarit Dado, Albanian citizen, born in Albania on 04.10.1983, identity card holder with number I31004089C. who, decides to sign these Articles of Association of a limited liability company, whose activity will be performed pursuant to the Albanian legislation in force and these Articles of Association.

**TITLE I
FORM - COMPANY'S NAME – OBJECT OF
ACTIVITY - REGISTERED OFFICE – DURATION**

Article 1 - Form

- 1.1. The company named " Interbalkan Medical Assistance" Ltd. (hereinafter the "Company") is incorporated as a private limited liability company, and its activity will be performed pursuant to these Articles of Association and its Memorandum of incorporation.
- 1.2. The Company acts pursuant to the Albanian legislation in force.
- 1.3. The Memorandum of Incorporation and the Articles of Association are in accordance with the mandatory Albanian legislation, and the issues which are not expressly provided herein will be regulated by the Albanian legislation.

Article 2 - Company's Name

The denomination of the Company is "Interbalkan Medical Assistance" Ltd.

Article 3 – Object of Activity

- 3.1. The object of activity of the Company is the carrying out of the commercial activities in compliance with the Albanian applicable legislation.
- 3.2. In more details, the Company will perform commercial activity:
International mediation for:
 - International foreign insurance companies,
 - Vehicle service. Carrot Service. Road Vehicle Service, Road Assistance,



- Shërbime mjeksore të ndryshme si ndihma e parë, transport me ambulance, shërbime mjeksore të specializuara etj.
- Shërbime mjeksore në ambientet e akomodimit të klientit etj.
- Të shërbimit të transporteve kombëtare dhe nderkombëtare me Ambulance dhe Air Ambulance,
- Të shërbimeve të transporteve kombëtare dhe nderkombëtare ajrore, detare dhe tokësore të personave të rëndësishëm sipas Vecante V.I.P. dhe sipas kërkesave të klienteve.

Neni 4 - Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në: Njësia Administrative Nr.5, Rruga "Sami Frasheri", Pallati Delta 1, Shkalla 2, Kati 2, Nr.7, Tirane, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të papërcaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 - Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 2,000,000 lekë (Dy milion lekë).
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e gjitha e nënshkruar dhe e shlyer, me vlerë nominale 2,000,000 lekë (Dy milion lekë).

- Transportation of customers in case of accident
- Various medical services such as first aid, ambulance transport, specialized medical services, etc.
- Medical services in the client accommodation facilities, etc.
- National and international transport service by Ambulance and Air Ambulance,
- National and international air, sea and land transport services of persons of Special importance V.I.P. and according to customer requirements.

Article 4 - Registered Office

- 4.1. The registered office of the Company is in Administrative unit no.5, "Sami Frasheri" street, Delta 1 Palace, Entrance 2, Floor 2, No. 7, Tirana, Albania.
- 4.2. The transfer of the registered office of the company will be made by resolution of the General Meeting.
- 4.3. The General Meeting may open subsidiaries, branches, and representative offices inside the territory of Albania.

Article 5 - Duration

- 5.1. The duration of the Company will be for an indefinite period.
- 5.2. The Company may be dissolved before this term or the duration of the company may be extended through a resolution of the General Meeting.

TITLE II CAPITAL - QUOTAS - CONTRIBUTIONS AND TRANSFER OF QUOTAS

Article 6 - Capital

- 6.1. The capital of the Company is 2,000,000 ALL (Two million ALL).
- 6.2. The capital of the Company consists of 1 (one) quota, totally subscribed and paid, with a par value of 2,000,000 ALL (Two million ALL).

Neni 7 – Kontributet

- 7.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
Ortaku i vetëm i shoqërisë Z. Margarit Dado ka ofruar një kontribut në para të barabarte me 2,000,000 lekë (Dy milion lekë), nëpërmjet depozitimit pranë një bankë në Shqipëri.
- 7.2. Sipas kontributeve të mësipërme:
Z. Margarit Dado i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2. Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakeve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1. Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2. Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.

Article 7 – Contribute

- 7.1 The contribute on the capital of the Company is provided as follows:
The sole quota holder of the company Mr. Margarit Dado, has contributed in money in the capital of the company with a sum equal to 2,000,000 ALL (Two million ALL), which has been deposited in a bank in Albania.
- 7.2 Based on the cited contributions:
Mr. Margarit Dado owns 1 (one) quota of the capital, equal to 100% (one hundred percent) of the capital.

Article 8 – Increase of share capital

- 8.1. The General Meeting may increase without any limit, one or few times, the Company's share capital.
- 8.2. In case of increase of share capital, all quota holders have the right to subscribe the increase in proportion to their quotas in the capital. In case some of the quota holders waive their right to subscribe for their portion, the unsubscribed capital may be subscribed by the other quota holders in proportion to their quotas in the share capital.

Article 9 – Reduction of share capital

- 9.1. The General Meeting may resolve to reduce the Company's share capital. In any case the Company's share capital may not be reduced under the limit provided by the law.
- 9.2. The quota holders afford the reduction of the Company's share capital in proportion to their quotas in the share capital.

Article 10 – Transfer of Quotas

- 10.1. Quotas of the capital may be freely transferred between quota holders.
- 10.2. In case of transfer of any form, with as well without consideration, including donation in favor of other subjects different from quota holders, the quota should be offered in priority to other quota holders.



10.3. Në një rast të tillë ortakët që do të transferojnë kuotën e tyre duhet të njoftojnë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e bleresit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje.

10.4. Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

11.1. Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

12.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.

10.3. In such a case the quota holders that will transfer his quota should notify the other quota holders, with written notice by registered mail, on sale purpose, specifying the price, all terms and conditions of the transfer, indicating the name of the cessionary quota holder. The prior right for purchase should be referred to all quotas offered in sale.

10.4. Within 15 (fifteen) days from the receiving of the written notice by mail registered, the quota holders inform the transferor on his purpose to exercise or not the prior right for purchase. Should the other quota holders not inform the transferor as per the above term, is presumed to have given up their rights of prior right for purchase.

10.5. In case the prior right for purchase is not exercised, the quotas can be transferred to third parties, in whole or partially, by positive resolution of the General Meeting.

TITLE III GENERAL MEETING, ADMINISTRATORS AND PUBLIC CERTIFIED ACCOUNTANT

Article 11 – Powers of general meeting

11.1. The decision-making body of the Company shall be the General Meeting.

11.2. The general meeting is responsible for the decision making regarding the following issues: amendments to by-laws, nomination and dismissal of administrators, public certified accountant and liquidators, increase and decrease of capital, quota transfer, profit distribution, re-organization and resolve of the company, approval of the balance sheet and for any other decision provided from the present by laws or by the respective legislation.

Article 12 – Participation and voting right

12.1. Each quota holder has the right to participate in the General Meeting, to present his opinion and cast his vote in proportion to his quotas.

- 12.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2. Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.
- 13.4. Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në piken 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

- 12.2. Each quota holder has the right to be represented from one person non-quota holder, provided by written special proxy, through which can cast his vote.
- 12.3. The quota holder cannot issue a power of attorney for a part of his quotas in event he shall exercise his voting powers for the remaining of his quotas.

Article 13 – Convocation of General Assembly, Quorum and Resolutions

- 13.1. The General Meeting is called at least once a year, within 6 (six) months from the closing of the financial year in order to approve the balance sheet, report of the Administrator, chartered accountant as well as the inventory.
- 13.2. The General Meeting can be called in every moment from one of the Administrators as well as one or some quota holders which represent at least 5% (five percent) of the capital. The meeting should be called through written notice by registered mail which should be sent to the quota holders – at the address resulting at the quota holders register – and to the public certified accountant (if nominated) at least 15 (fifteen) calendar days before the meeting. The notice must contain the agenda to be discussed, venue, time and day of the first and second call.
- 13.3. Assembly can be called out of the Company headquarters.
- 13.4. In case the General Meeting is not called at first call due to default of provided quorum in the point 13.7 of the present Articles of association, the General Meeting will be called within 30 (thirty) days with the same agenda to be discussed.



- 13.5. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6. Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë me shume se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortakeve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8. Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9. Cdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10. Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

- 13.5. The General Meeting may be held through the participation of the people present in different places, connected by telecommunication means, provided that all the participants can be identified and to be allowed to follow the discussion and to interfere at the moment of the issue treatment on the agenda; after those requirements have been verified which should result at the minutes of meeting, the Assembly is considered held where the Chairman stand where should be standing the Secretary of the meeting as well.
- 13.6. The meeting will be called and held regularly, disregarding these formalities, in case that are present the quota holders which represent all the share capital.
- 13.7. The resolutions of General Meeting, for which is requested a simple majority, are valid if there are present the shareholders representing more than 30% (thirty percent) of the share capital. The resolutions of the General Meeting requesting a specific majority, are valid if are present the quota holders representing at least 51% (fifty one percent) of the share capital.
- 13.8. The General Meeting resolves on the change of the Articles of Association. Increase and decrease of share capital, transfer of quotas, distribution of profits, reorganization and dissolving of the company, with the favorable vote of $\frac{3}{4}$ (three fourth) of the present quota holders holding at least 51% (fifty-one percent) of the share capital. In all other cases, the General Meeting resolves on the majority of votes of the quota holders holding more than 30% (thirty percent) of the share capital.
- 13.9. Every General Meeting is chaired by one quota holder or other person nominated by the meeting. The General Meeting appoints a secretary, which could be a non-quota holder, to record the resolution.
- 13.10. The resolutions of the General Meeting are signed by the Chairman and Secretary of the meeting.



Article 14 – Administrator

Neni 14 – Administrimi

- 14.1. Shoqëria administrohet nga të pakten 1 (një) Administrator i cili do të qendrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
- 14.2. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 14.3. Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
Z. Margarit Dado, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë, Shqipëri me 04.10.1983, mbajtës i letërnjoftimit Shqiptar me nr personal I31004089C.
- 14.4. Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1. Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislati në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1. Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 dhjetor të të njejtit vit.

- 14.1. The company is administered by at least 1 (one) Administrator who will remain in charge until resignation or removal or for a period of 5 (five) years.
- 14.2. The legal representation of the company is conferred to the Administrator. The Administrator may exercise all powers in conformity with the provisions in Article 95 of Law n. 9901, date 14.04.2008 "For traders and trading companies".
- 14.3 With the present act is appointed 1 (one) Administrator of the Company who is the following person:
Mr. Margarit Dado, Albanian citizen, born in Tirana, Albania on 04.10.1983, with personal no. I31004089C.
- 14.4. The Administrator can appoint a special representative for certain actions or categories of actions.


Article 15 – Certified Public Accountant

- 15.1. If necessary or requested by the law, the audit of the balance sheets and accounting books of the Company shall be performed by one or more certified public accountants.
- 15.2, The certified public accountant may be dismissed in compliance with the procedure provided by applicable law.

TITLE IV FINANCIAL YEAR, ANNUAL BALANCE SHEET, DISTRIBUTION OF PROFITS

Article 16 – Financial Year and Annual Balance Sheet

- 16.1. The financial year commences on January 1st and closes on December 31st of each year.
- 16.2. The financial fiscal year commences on the date of the registration of the Company with the National Registration Center and ends on December 31st of the same year.



- 16.3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji nr. 9901 te datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 16.4. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2. Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1. Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose perpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2. Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1. Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

- 16.3. The annual balance sheet, financial statements, inventory, reports of the Administrator and certified public accountant are approved by the General Meeting with the majority requested as per Law no. 9901, dated April 14, 2008 "On entrepreneurs and commercial companies".
- 16.4. The documents related to the financial year must be approved within 6 (six) months from the closure of the financial year.

Article 17 – Profits

- 17.1. Profits resulting from the annual balance sheet are distributed to the quota holders in proportion to their quotas.
- 17.2. The General Meeting may decide to create extraordinary or special reserves for specific purposes or even the postponement of the distribution of the profits – totally or partially for the future financial years.

TITLE V DISSOLUTION AND LIQUIDATION

Article 18 – Dissolution

- 18.1. The Company may be dissolved before the term provided in the Articles of Association or in other cases provided by law or through a resolution of the General Meeting, which should be adopted with the affirmative vote of the quota holders requested for the modification of the Articles of Association.
- 18.2. The Company is not dissolved in cases of inability to act, legal incapacity, death, liquidation or bankruptcy of the quota holders.

Article 19 – Liquidation

- 19.1. When dissolved, the company must be liquidated.
- 19.2. To administrate this procedure, the General Meeting appoints one or more liquidators, who will draft the final report on the assets and liabilities of the Company, and on the operations of the liquidation and necessary time for the liquidation.



19.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjeset e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejte ndërmjet palëve të interesuara.

20.1 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën angleze.

21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në shqip do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërish detyrues.

19.3. At the end of the liquidation procedure, the General Meeting will decide upon the final balance sheet, the work performed by the liquidator/s and termination of the liquidation process.

19.4. Following the payment of the creditors and collection of the outstanding credits, liquidator/s will distribute the final income of the liquidation to the quota holders, in proportion to their quotas.

Article 20 – Dispute Resolution

20.1. All disputes arising from or in any way connected or related to the interpretation and/or execution of these Articles of Association and Memorandum of Association, between the quota holders (except of those personal or out of the Company) or between one or more quota holders and the Company, will be solved in an amicable way and settled directly between the interested parties.

20.2. If an amicable settlement of the dispute is not reached, it shall be referred to the District Court of Tirana.

Article 21 – Language

21.1. These Articles of Association is drafted in 3 (three) copies in Albanian with annexed the English translation.

21.2. For every dispute arising from the application and/or interpretation of the present act, the Albanian version will be binding and the sole having legal effect.

ORTAKU I VETËM/SOLE QUOTA HOLDER
"INTERBALKAN MEDICAL ASSISTANCE"
SHPK
Mr. MARGARIT DADO

